REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 719/20
Date/Datum. 12.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

***Ilaz Papaj**-Ekspert Shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit 01.10.2020*	*Data e dorëzimit të raportit 12.10.2020*	*Nr. i lëndës:* *719/20*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.09.2020,grupi i OE N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk & "Company Zuka Commerce"Shpk-Gjakovë,ka parashtruar ankesë me nr: 719/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë,OE N.N.Sh"Korben" - Gjakovë,lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve"** me nr.prokurimi 632-20-1237-5-2-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Komuna e Gjakovës".
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës: **Kontratë Publike,Punë,**vlera e parashikuar e kontratës: **200,000.00 €.**

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka një vendim të OSHP-së,PSH.nr 426/20 të datës 28.07.2020 me të cilin është rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- **Neni 6 i LPP-së**
- **Neni 7 i LPP- së**
- **Neni 56 i LPP-së**
- **Neni 59 i LPP-së**
- **Neni 60 i LPP-së**
- **Neni 69 i LPP-së**
- **Neni 71 i LPP-së**
- **Neni 27 i RRUOPP-së**

- **AK ka shkelur edhe dispozitat e RRUOPP-së gjatë vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të**

tenderëve si dhe ka shkelur edhe praktikat e mira të prokurimit.

Gjate vlerësimit të tenderëve me rastin e rivlerësimit, AK ka bërë prapë shkelje të LPP-së ku pretendimet tona lidhur me këto shkelje janë si në vijim:

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin **6 të LPP-së** lidhur me Ekonomicitetin dhe Efikasitetin sepse ky nen decidivisht e thotë që: **të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit**, ndërsa tek rasti jonë AK-Komuna e Gjakovës nuk ka vepruar sipas këtij neni, por përkundrazi tenton ta dëmtoj buxhetin e komunës duke e shpërblyer një OE që posedon çmimin më të lartë se ne. Edhe më të rëndë e bënë shkeljen e nenit 6 të LPP fakti se OE i shpallur fitues nuk është i përgjegjshëm pasi që në ofertën e tij mungojnë dëshmi mbi posedimin e disa prej pajisjeve të kërkuara.

Vlerësimi i tenderëve duke mos vepruar sipas kërkesave të nenit 7, 59, 60, 69 dhe 71 të LPP-së e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 6 të LPP-së dhe drejt dëmtimit të buxhetit të komunës.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin **7 të LPP-së** i cili ndër të tjera kërkon nga AK që gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit: **ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese.**
Gjatë vlerësimit të tenderit tonë AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me këtë nen pasi që edhe përkundër asaj që ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit si dhe kemi pasur çmimin më të ulët në krahasim me OE të shpallur fitues, na eliminon nga konkurrenca për arsye krejtësisht të pa-bazuara. Kështu duket arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë nga konkurrenca:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Ju keni ofertuar si Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.Sh.,,Marash - Shped Sh.p.k; Company Zuka Commerce Sh.p.k., Sadik Stavileci, 50000, Gjakove dhe në procesverbalin e hapjes së tenderit,figuron si Lider i Grupit Operatori Ekonomik NTSH.Marash-Shped shpk;,nderasa në dokumentacionin e dorzuar është ndryshuar Lideri i grupit Company Zuka Comerce shpk;
Sipas rregulave te prokurimit oferten e dorezon bartesi dhe kjo specifikohet ne formular per dorezim te tenderit si Operatori Ekonomik me nr. 1 ndersa ne deklarata per themelim te grupit te jepen OE tjere pra duhet shikuar Operatori Ekonomik i cili eshte me nr. 1 ne formularin e krijuar te sistemit.

Sipas Vendimit të OSHP-së nr.781/19 i datës 09.12.2019 bartës i projektit është OE i cili i pari dorëzon ofertën në e-prokurimi nr.1", "meqenese ka mosperputhje mes liderit te dhene ne formular dhe deklarata per themelim te grupit.

Ju si Lider I grupit nuk I përmbusheni 60% te vleres prej 300.000,00€ ashtu siq është kërkuar në FDT.

Pra arsyetimi i AK-së dhe eliminimi jonë për gjoja tenderin nuk e ka dorëzuar lideri i grupit është plotësisht i pabazuar në rregullat dhe dispozitat LPP-së që flasim për mënyrën, formën dhe të drejtën e dorëzimit të

ofertave. AK fillon procedurat e prokurimit dhe i zbaton ato në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik, dhe rregulloret tjera të lëshuara nga KRPP-ja dhe asesi nuk ka të drejt të zbatoj vendime tjera të cilat nuk lidhen fare me këtë procedurë. Më saktësisht këtë fakt do ta gjeni të argumentuar edhe tek **Pretendimi 4.**
Pra po shihet qartë sjellja jo profesionale e AK-së duke na **diskriminuar** neve edhe pse i kemi të gjitha dëshmitë e nevojshme sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe duke e **favorizuar** OE të shpallur fitues që kishte çmimin më të lartë se ne dhe i mungonin disa nga pajisjet e kërkuara në dosjen e tenderit. Kjo është një tregues shumë i qartë që dëshmon se AK ka shkelur plotësisht nenin 7 të LPP-së.

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenin **56 të LPP-së** i cili kërkon nga AK që gjatë vlerësimit të tenderëve:

1. **Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:**

1.1 së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit
28 të këtij ligji;
1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin
60 të këtij ligji.

AK nuk e ka respektuar këtë dispozitë të LPP-së sepse tenderin tonë e nuk e ka vlerësuar sipas kërkesave të dosjes por përkundër kësaj na ka eliminuar nga konkurrenca për kritere që i plotësojmë saktë ashtu siç janë kërkuar në dosje të tenderit. AK nuk ka respektuar nenin 56 të LPP-së as gjatë vlerësimit të tenderit të OE që e ka shpallur fitues pasi që i njëjti kishte mangësi të theksuara tek pajisjet e kërkuara për ekzekutimin e punimeve.
Në bazë të kësaj shihet haptazi se AK ka shkelur plotësisht nenin 56 të LPP-së.

Pretendimi 4: AK ka shkelur nenin **59 të LPP-së** pasi gjatë ri-vlerësimit të tenderëve nuk e ka respektuar dhe shfrytëzuar fare paragrafin 4 (katër) të këtij neni.

Neni 59.4 thotë që:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Përkundër kësaj që ja kërkon nenin 59.4 i LPP-së si dhe përkundër asaj që oferta jonë ka qenë plotësisht e kompletuar, AK prapë se prapë na ka shpallur të papërgjegjshëm për një arsye krejtësisht të kundërligjshme dhe të **pa-bazuar**. Arsyeja e eliminimit tonë ishte për gjoja se:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Ju keni ofertuar si Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.Sh.,,Marash - Shped Sh.p.k; Company Zuka Commerce Sh.p.k., Sadik Stavileci, 50000, Gjakove dhe në procesverbalin e hapjes së tenderit,figuron si Lider i Grupit Operatori Ekonomik NTSH.Marash-Shped shpk;,nderasa në dokumentacionin e dorzuar është ndryshuar Lideri i grupit Company Zuka Comerce shpk;
Sipas rregulave te prokurimit oferten e dorezon bartesi dhe kjo specifikohet ne formular per dorezim te tenderit si Operatori Ekonomik me nr. 1 ndersa ne deklarata per themelim te grupit te jepen OE tjere pra duhet shikuar Operatori Ekonomik i cili eshte me nr. 1 ne formularin e krijuar te sistemit.

Sipas Vendimit të OSHP-së nr.781/19 i datës 09.12.2019 bartës i projektit është OE i cili i pari dorëzon ofertën në e-prokurimi nr.1", "meqenese ka mosperputhje mes liderit te dhene ne formular dhe deklarata per themelim te grupit.

Ju si Lider I grupit nuk I përmbusheni 60% te vleres prej 300.000,00€ ashtu siq është kërkuar në FDT.

Kjo nuk është trajtuar si duhet sepse AK është thirrur në një vendim të OSHP-së për një tender krejt tjetër ndërsa nuk ka respektuar rregullat dhe dispozitat e LPP-së, mbi bazën e së cilave edhe duhet zhvilluar të gjitha procedurat e prokurimit.
Ne kemi bërë marrëveshje të konzorciumit me një tjetër OE pjesëmarrës në këtë grup dhe në bazë të marrëveshjes edhe është caktuar lideri i grupit. Përpos kësaj, sipas marrëveshjes është autorizuar edhe anëtari i grupit i cili do të jetë kompetent për të nënshkruar në emër të grupit, për ta përfaqësuar atë, si dhe për të vepruar (dorëzuar tenderin) në emër të këtij grupi të OE-ve (*shihe të bashkangjitur dëshminë e tillë*). Mbi bazën e kësaj ne anëtari i grupit të OE-ve "**N.T.SH. Marash-Shped SH.P.K.**" kemi vepruar duke e përgatitur tenderin dhe duke e dorëzuar atë. Pavarësisht kësaj lider i grupit mbetet OE tjetër pra "**Company Zuka Commerce SH.P.K.**" sepse i njëjti është caktuar lider me marrëveshjen që ne së bashku e kemi nënshkruar e të cilës do ti përmbahemi deri në fund të këtij projekti.

Tirrja e AK-së për gjoja se sipas rregullave të prokurimit ofertën e dorëzon bartësi dhe gjoja kjo specifikohet në formularin e dorëzimit të tenderit si OE nr.1, nuk është e vërtet sepse askund në LPP, RRUOPP dhe në ndonjë udhëzues tjetër të lëshuar nga KRPP-ja, nuk saktësohet se kush ka të drejt apo nuk ka të drejt të dorëzoj tenderin. Thjesht thuhet se anëtarët e grupit të OE duhet të kenë marrëveshje ku caktohet lideri dhe ku caktohet personi apo OE që do të nënshkruar, përfaqësoj apo veproj në emër të grupit. Këtë ne e kemi bërë saktë sipas nenit 71 të LPP-së dhe sipas nenit 27 të RRUOPP-së. Po të ishte rregulle që vetëm lideri duhet ta dorëzoj tenderin, atëherë shtrohet pyetja, pse tek marrëveshja e konzorciumit kërkohet të caktohet edhe personi apo kompani që do të nënshkruar dhe veproj në emër të grupit?

Askund dhe në asnjë dispozitë që flet për prokurimin publik nuk ceket se kush ka të drejt apo jo të ngarkoj tenderin në e-prokurim. Deklarimi i AK-së se gjoja të drejtën për ngarkim të tenderit në e-prokurim e ka bartësi i grupit, është pak konfuze sepse nuk e ka cekur fare se në bazë të cilës dispozitë ka ardhë deri tek ky përfundim dhe se askund nuk sqarohet saktë se çka nënkupton fjala bartës i grupit. Në rastin tonë dhe duke u bazuar në marrëveshjen e konzorciumit, i bie që ne jemi bartës të grupit sepse kemi të drejtën të veprojmë në

emër të grupit, ndërsa LIDER(udhëheqës) i grupit është anëtari tjetër i grupit i cili i ka përgjegjësitë dhe kompetencat e veta gjatë të procesit të prokurimit e deri në implementimin e plotë të kontratës.
Edhe thirrja e AK-së në një vendim të OSHP-së nga një procedurë tjetër e prokurimit, nuk ka fare kuptim për deri sa AK-ët sipas nenit 1, 2 dhe 3 të LPP-së janë të obliguara që të procedurat e prokurimit të i zhvillojnë vetëm sipas LPP-se dhe udhëzuesve tjerë të lëshuar nga KRPP. Edhe më të pakuptimët e bënë fakti se atë vendim të OSHP-së në të cilin është thirrur AK, nuk e ka respektuar vetë AK-ja tek procedura përkatëse për të cilën është lëshuar. Tash shtrohet pyetja? si është e mundur që vendimi që është lëshuar për projektin përkatës të mos respektohet e të gjejë zbatim në një proces krejt tjetër të prokurimit.
Përpos kësaj ky vendimi ishte i lëshuar për një aktivitet të caktuar të prokurimit dhe në asnjë rast nuk mundet të aplikohet në procese tjera të prokurimit që nuk kanë fare lidhshmëri në mes veti.

Thirrja e AK-së tek formulari i dorëzimit të tenderit që gjoja sipas AK-së anëtari i 1(parë) duhet dorëzuar tenderin, nuk është e bazuar sepse askund në atë formular nuk ceket lideri por vetëm se anëtarët janë të renditur me numra pa ndonjë kriter dhe qëllim të veçantë. Ja si duket formulari i tillë:

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plotë: **Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.Sh.,,Marash - Shped Sh.p.k; Company Zuka Commerce Sh.p.k., Sadik Stavileci, 50000, Gjakovë, Kosovë**

E-mail: **marashshped.ks@gmail.com**

Personi kontaktues: **Albert Bala**

Telefoni: **+383/45230702**

Faxi:

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri **1.**

Emri i kompanisë: **N.T.Sh.,,Marash - Shped Sh.p.k**

Numri fiskal: **600526315**

Vend-Selia: **Sadik Stavileci, 50000, Gjakovë, Kosovë**

Partneri **2.**

Emri i kompanisë: **"Company Zuka Commerce" Sh.p.k.**

Numri fiskal: **600112461**

Vend-Selia: **Metush Krasniqi nr.135, 60 000, GJILAN, Kosovë**

Bazuar në këtë nuk mundemi as ta kuptojmë se ku e ka lexuar atë që thirret AK-ja se sipas formularit të tillë lideri është nën numrin 1. Aty shkruan vetëm partneri 1 dhe partneri 2 etj....

Përpos kësaj tek pika 6 e këtij formulari flitet vetëm për obligimet e grupit që do ti ketë gjatë implementimit të kontratës dhe askund nuk shkruan asgjë për të drejtën e dorëzimit të tenderit. Ja si duket pika 6 e këtij formulari:

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [*shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet*] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [*shëno emrin e udhëheqësit*]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

Po të ishte ashtu siç thotë AK-ja, atëherë tek pika 6 e formularit të tenderit aty te vendi ku shkruan "*shëno emrin e udhëheqësit*", sistemi do ta shënonte vet emrin e liderit të grupit e që sipas AK i bie të jetë ai i OE që e ka bërë ngarkimin e tenderit. Kjo mundësi nuk të jepet nga sistemi dhe me vet faktin që sistemi nuk e vendosë automatikisht dhe e ka lënë si mundësi që në të ardhmen vet OE që e ngarkon tenderit t'a shkruar emrin e udhëheqësit të grupit, nënkupton se tenderin mundet ta dorëzoj kushdo nga anëtarët e grupit që marrin pjesë në atë tender ndërsa pavarësisht renditjes në këtë fushë shënohet emri i liderit/udhëheqësit të grupit.

AK ka bërë edhe shkelje administrative gjatë procesit të hartimit të raportit të vlerësimit pasi që raporti i vlerësimit të parë dhe raporti i ri-vlerësimit janë plotësisht njësoj vetëm se data në fund u ka ndryshuar. Sipas raportit të ri-vlerësimit dhe atyre që ka deklaruar komisioni i vlerësimit ne jemi eliminuar prapë për shkak të arsyeve të njëjta sikur herën e parë ndërsa tek letra standarde mbi arsyet e eliminimit kemi një arsyetim krejt tjetër pra atë që gjoja tenderi nuk është dorëzuar nga lideri i grupit. Këtu shihet se është manipuluar me komisionin e vlerësimit apo më mirë të themi se nuk është bërë fare ri-vlerësim. Edhe po që se ndryshohet deklarimi i komisionit të vlerësimit, ZKP duhet të përgatis një arsyeshmëri dhe ta bëjë pjesë të raporti të ri-vlerësimit e jo ta nënshkruaj raportin me arsyetime për eliminim që nuk përputhen fare me ato që ndodhet në fletën standarde të eliminimit. Shiko të bashkangjitur raportin e rivlerësimit dhe letrën standarde të eliminimit!

Pra bazuar në dëshmitë dhe argumentet që ju prezantuam këtu e të cilat si të plota mundeni ti gjeni edhe në ofertën tonë, shihet qartë se AK nuk ka vlerësuar fare në përputhje me kërkesat dhe dispozitat e LPP-së që flasin për vlerësimin korrekt të tenderëve. Arsyeja e eliminimit tonë shihet se është aplikuar gabimisht dhe kundërligjshëm pasi që e njëjta nuk mbështetet në nga asnjë dispozitë e LPP-së, RRUOPP-së si dhe në asnjë dispozitë tjetër apo udhëzues të lëshuar nga KRPP.

Ne kemi pasur takim me Departamentin e Rregullave të KRPP-së nga të cilët na është thënë zyrtarisht se tenderin mundet ta dorëzoj cilido nga anëtarët e grupit pavarësisht se a është lider apo jo. Për këtë qëllim jemi duke pritur edhe interpretimin ligjor me shkrim dhe posa ta kemi, do të ua dërgojmë si provë shtesë dhe si mbështetje të pretendimit tonë.

AK nuk ka respektuar fare nenin 59.4 as kur bëhet fjalë për vlerësimin e tenderit të OE të shpallur fitues. Edhe këtu AK nuk ka zbatuar rekomandimet e OSHP-së të përcaktuara me vendimin për ri-vlerësim të tenderëve. Në dosjen e tenderit ishte kërkuar që OE të ofrojnë dëshmi mbi posedimin e pajisjeve ose marrjen me tyre në shfrytëzim si dhe kishte kërkuar edhe dëshmi mbi pronësinë e tyre(libreza qarkullimi, duda doganor, fatura, etj). Kështu kishte qenë kërkesa në dosje:

	Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-paisje teknike për realizimin e kontratës siq janë** **a.) 1 eskavator (makineri me strukturë rrotullnese) me peshë totale mbi 10t,** **b.) 2 kamiona me konstruksion ndërtim kiper me peshë totale mbi 10t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit)** **c.) 2 cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale mbi 7t** **d.) 1 bager deri në 10 t.**	**Lista e mjeteve-paisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit).** **Operatori Ekonomik duhet të sjell dëshmi njërën prej këtyre dokumenteve kopje të librezës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata mbi qiramarrjen të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (kopje).**	

OE i shpallur fitues nuk ka arritur të ofroj dëshmi të pranueshme sipas këtyre kërkesave për njërin kamion me peshë mbi 10 ton, për dy cilindra me peshë mbi 7 ton dhe për bagerin me peshë mbi 10 ton. Dëshmitë që i ka ofruar nga lista e pajisjeve që i ka në pronësi të veten nuk e arrijnë peshën e kërkuar andaj edhe konsiderohet si kriter i paplotësuar. Në ofertë ka paraqitur dy lista të pajisjeve për të cilat pretendon se janë në pronësi të tij por dëshmitë e ofruara për këto pajisje nuk e plotësojnë kërkesën e AK-së sa i përket peshës së tyre. Ja dëshmia:

LISTA E PAISJEVE

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhënat për pajisjet (viti I prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexh. I targave,mekanizimi ,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj)
1	eskavator (makineri me strukturë rrotulluese) me peshë totale mbi 10t,	1	1	Volvo
2	kamiona me konstruksion ndërtim kiper me peshë totale mbi 10t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit	2	2	MAN, 07-893-DF IVECO, 07-766- CQ
3	cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale mbi 7t	1	1	Bitelli
4	1 bager deri në 10 t	1	1	R914 HDSLIitronic,

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____

Ndërmarrja Ndërtimore Shërbyese KORBEN 811129726 GJAKOVË

N.N.SH KORBEN

044 500 810 | 044 133 586

Lista e Paisjeve nga NNSH "Korben"

Nr.	Pershkrimi i paisjes				Ne posedim	
	EMERTIMI	MARKA/ TIPI ETJ	Viti i Prodhimit	Pesha bartese	nr fat./dud/ librez qarkull.	emri i kompanise
	PAISJE TRANSPORTUESE					
1	KAMION	MAN, Tipi: TGA 28.430	2005	13 ton	R 3311	NNSH Korben
2	KAMION	IVECOI Tipi: 170 34 4X4	1990	8 ton	R 2854	NNSH Korben
3	KAMIONET			2 ton	CRA/YPB/VRC 0774959	NNSH Korben
4	DUMPER	Marka&Tipi: KPC2000 RK-H	1989	1.5 ton	18-SHV01-001-13	NNSH Korben
	PAISJE PER NGJESHJE ...					
1	RUL PER SHTRIMIN E RRUGEVE	Marka: BOMAG, Tipi: BW75ADL	1981	1.2 Ton	18-SHV01-001-13	NNSH Korben
	NGJESHESE DHEU	Me vibrim		5 Ton	16-SHV01-001-20	NNSH Korben
2	NGJESHESE DHEU	Marka: Ammann, me vibrim	1988	700 kg	19-SHV01-001-12	NNSH Korben
3	NGJESHESE DHEU	Marka: Wacker Neuson , me vibrim	1990	456 kg	19-SHV01-001-12	NNSH Korben
	PAISJET TJERA, EXAVATORET-BAGERAT ETJ					
1	EKSAVATOR	Marka: VOLVO, Tipi EC230B, Me lug ngarkuese	1997	23.7 ton	R 3299	NNSH Korben

NNSH "Korben"

Nga vet lista e pajisjeve që ka paraqitur ky OE shihet se nuk i posedon pajisjet ashtu siç janë kërkuar në dosjen e tenderit sa i përket peshave të tyre dhe pronësisë. Pajisjen që i ka në pronësi nuk e plotësojnë kushtin e kërkuar nga AK. Ky OE ka paraqitur edhe një marrëveshje me kompaninë AIM SH.P.K. lidhur me marrjen në shfrytëzim të pajisjeve. Kjo kompani në bazë të një marrëveshjeje shihet se pajisjet e tilla i ka blerë nga kompania STE Kosova SHPK mirëpo në dudat doganorë të këtyre pajisjeve nuk figurojnë të dhënat se këto pajisje ishin pronë e kompanisë STE Kosova SHPK. Përpos që në bazë të DUD-ave doganor shihet se këto pajisje i përkasin kompanisë MIRUSHA TRANSPORT SHPK, për pajisjet që janë në marrëveshje për shfrytëzim në mes NNSH Korben dhe AIM SHPK mungojnë edhe dëshmi lidhur me këto pajisje.

Pra përfundimisht konstatohet se kompania e cila është shpallur fituese nga AK nuk i posedon të gjitha pajisjet e kërkuara në dosjen e tenderit pasi nuk ka arritur të dëshmoj me dokumentet e kërkuara pronësinë e tyre. Edhe te marrëveshja mungojë dëshmi se pajisjet i përkasin kompanisë me të cilën ka bërë marrëveshje për shfrytëzim.

Këtu shihet qartë se AK nuk ka vlerësuar drejt ofertën e OE të shpallur fitues pasi që edhe përkundër mangësive që kishte në ofertën e tij, e konsideron të përgjegjshëm dhe pa të drejt e shpall edhe fitues. Dëshmitë mbi pajisjet e këtij OE nga ku mundeni ti vërtetoni pretendimet tona dhe ta shihni se ky OE nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për pajisjet kërkuara, i gjeni të bashkangjitura si dëshmi mbështetëse të ankesës por edhe në ofertën e OE NNSH Korben.

Nisur nga kjo nuk kemi se si të mendojmë ndryshe veç se AK – Komuna e Gjakovës ka shkelur plotësisht nenin **59 të LPP-së** që ndërlidhet me ri-vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit.

Pretendimi 5: AK ka shkelur nenin **60 të LPP-së** si pasojë e mos vlerësimit real të ofertave sipas kërkesave të dosjes së tenderit, asaj që kërkon neni 6, neni 7, neni 56 dhe neni 59 i LPP-së. Renditja e çmimeve ishte si në vijim:

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]
1.	N.T.P. "Beni" Planqor, Gjakovë, 50000, PLANQAR	147.162,62€
2.	Visar Kuçi B.I. V.Qerqilli Nr. 51, SUHAREKË	173.875,99€
3.	"D & T Group" SH.P.K. Sadik Pozhegu / p.n., 50000, GJAKOVË	127.539,15€
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik JOOS & KRASNIQI -BAZE SH.P.K.: N.P.N. "VIZION-PLUS" JUNIK, 51050, JUNIK	173.900,90€
5.	VB. TOFAJ QENDËR, 51050, JUNIK	189.185,26€
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.Sh.,,Marash - Shped Sh.p.k; Company Zuka Commerce Sh.p.k. Sadik Stavileci, 50000, Gjakove	146.406,80€
7.	Mirusha Company Sh.p.k. Rruga "Abedin Rexha" p.n., 32000, Klinë	194.830,84
8.	N.N.SH. "Korben" Rr. Domenik Pergega p.n., 50000, Gjakovë	147.393,86
9.	N.SH.T. VIKTORY COM Rr. Tirana, 50000, Gjakovë	120.821,79

Pra nga kjo shihet se AK nuk ka respektuar as kriterin "**Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët**", shkelje e cila vjen si pasojë e mos futjes fare në garë të kompanisë tonë sipas kriterit të vlerësimit që ishte i paraparë në dosjen e tenderit. Kjo ka ardhur për shkak të mos respektimit të neneve tjera të LPP-së por pavarësisht kësaj, s'kemi si të mos mendojmë ndryshe veç se AK **nuk** ka vlerësuar sipas kriterit të paraparë në dosje të tenderit. AK pa të drejtë na anashkalon neve duke kaluar tek OE me çmim më të shtrenjtë se ne, e që është edhe tenderues i papërgjegjshëm. Ne realisht kemi dorëzuar tender plotësisht të përgjegjshëm dhe kemi çmimin më të ulët se sa fituesi dhe më të ulët edhe se të gjithë tenderuesit tjerë të përgjegjshëm.

Kjo është në kundërshtim të plotë me shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë efikase dhe efektive por me të drejtë konsiderohet edhe shkelje e plotë me nenin 60 të LPP-së.

Pretendimi 6: AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së sepse gjatë vlerësimit të tenderit tonë nuk i ka trajtuar si duhet dëshmitë e ofruara lidhur me mundësit teknike dhe profesionale. Nenin 69 të LPP-së, AK e ka shkelur me rastin e vlerësimit të tenderit që e ka shpallur fitues pasi që i njëjti nuk i plotëson kërkesat për pajisjet dhe makineritë e kërkuara. Kjo konsiderohet mos respektim i kritereve të vendosura nga vet AK paraprakisht në dosjen e tenderit dhe njëkohësisht del të jetë shkelje e plot e nenit 69 të LPP-së.

Pretendimi 7: AK gjatë vlerësimit të tenderëve ka shkelur edhe dispozitat e RRUOPP-së që flasin për vlerësimin dhe krahasimin e mirëfilltë të tenderuesve. Si dispozitë të shkelur kisha me i cekur nenin 26, 28 dhe 41 të RRUOPP-së. Mos respektimi i këtyre dispozitave si dhe mos respektimi edhe i dispozitave të LPP-së që i cekëm më lartë e shtynë AK drejt mos respektimit edhe të praktikave ma të mira të prokurimit lidhur me vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara, shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes Ankesën tonë kundër vendimit të AK-së dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar duke marrë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e **Grupit të OE "N.T.SH. Marash-Shped SH.P.K. & Company Zuka Commerce SH.P.K."** lidhur me tenderin **"Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve"**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e **AK – KOMUNA GJAKOVË** dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe në detyrimet që i ka AK-ja ndaj LPP-së dhe RRUOPP-së e që realisht më pas do të duhej që **Fitues** të shpallej **Grupit të OE "N.T.SH. Marash-Shped SH.P.K. & Company Zuka Commerce SH.P.K."**

KRITERET PËR VLERËSIM

Neni 71 i LPP-se- Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

Neni 27 i RRUOPP-së –Grup i Operatorëve Ekonomik

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni i rivlerësimit nga nëntë (9) oferta të pranuara,vetëm një (1) ofertë e ka shpallur të përgjegjshme,duke rekomanduar për kontratë ofertën e OE N.N.Sh"Korben" - Gjakovë me çmim prej ***147,393.86 €.***
Sa i përket ofertës së grupit të OE ankues N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk & "Company Zuka Commerce"Shpk-Gjakovë, nga komisioni i rivlerësimit edhe pse si ofertë më e lirë ***(146,406.80 €)****,kjo ofertë është shpallur e papërgjegjshme me arsyetimin se në formularin për dorëzimin e tenderit lider i grupit eshte OE N.T.SH "Marash Shped" Shpk.ndërsa në deklaratën e grupit është specifikuar që lideri i grupit është OE"Company Zuka Commerce" dhe pas ndryshimit të liderit sipas vlerësimit të AK-së lideri i grupit nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për kontrata dhe referenca të realizuara ku është kërkuar që lideri duhet ti ketë 60 % të vlerës së kontratave të realizuara prej së paku 300,000.00 € në tri vitet e fundit.*

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË GRUPIT TË OE ANKUES N.T.SH"MARASH-SHPED" & " COMPANY ZUKA COMMERCE" SHPK -GJAKOVË

Përgjigje në Pretendimin 1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk & "Company Zuka Commerce"Shpk,se AK gjatë fazës së rivlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se në formularin për dorëzimin e tenderit lider i grupit është OE N.T.SH "Marash Shped" Shpk, ndërsa në deklaratën e grupit është specifikuar që lideri i grupit është OE"Company Zuka Commerce" dhe pas ndryshimit të liderit sipas vlerësimit të AK-së lideri i grupit (N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk) nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për kontrata dhe referenca të realizuara ku është kërkuar që lideri duhet ti ketë 60 % të vlerës së kontratave të realizuara prej së paku 300,000.00 € në tri vitet e fundit, që sipas OE ankues në deklaratën për themelimin e grupit të OE shumë qartë është theksuar që lider i grupit është OE "Company Zuka Commerce" dhe AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe nenit 27 të RRUOPP-së,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në vendimin e AK-së "B42 Letër standarde për tenderuesin/kandidatin e eleminuar",AK ka theksuar se tenderi i grupit të OE N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk & "Company Zuka Commerce"shpk është administrativisht i papërgjegjshëm me asyetimin se në procesverbalin e hapjes së tenderit,figuron si Lider i Grupit OE N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk,ndërsa në dokumentacionin e dorëzuar është ndryshuar Lideri i grupit" "Company Zuka Commerce".Sipas rregullave të prokurimit publik ofertën e dorëzon bartësi dhe kjo specifikohet në formular për dorëzimin të tenderit si Operator Ekonomik me nr.1 ndërsa ne deklaratën për themelim të grupit të jepen OE tjerë,pra duhet shikuar Operatori Ekonomik i cili është me nr.1 në formularin e krijuar të sistemit.Sipas vendimit të OSHP-së,nr.781/19 i datës 09.12.2019 bartës i projektit është OE i cili i pari e dorëzon ofertën në e-prokurim nr 1."meqenëse ka mospërputhje mes liderit të dhënë në formular dhe deklarata për themelimin e grupit.Ju si Lider i grupit nuk i përmbushni 60% të vlerës prej 300,000.00 € ashtu siq është kërkuar në FDT (Vendimi i AK-së).

Eksperti shqyrtues sqaron se grupi OE N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk & "Company Zuka Commerce"Shpk së bashku më dosjen e tenderit ka dorëzuar edhe Akt marrëveshjen për themelimin e grupit të OE në të cilën është specifikuar që Lider i grupit është OE "Company Zuka Commerce"Shpk ndërsa OE N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk është anëtar i grupit.
Gjithashtu ky grup i OE kanë dorëzuar edhe një autorizim të vulosur dhe nënshkruar nga të dy anëtarët e konzorciumit në të cilin është theksuar që Albert Bala (përfaqësues i anëtarit të konzorciumit N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk) autorizohet për të nënshkruar dhe dorëzuar dosjen e tenderit apo për të ofruar informata shtesë mbi atë apo nëse shpallet fitues edhe të nënshkruaj kontratën me autoritetin kontraktues.

Eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të dokumenteve të dorëzuara Lider i grupit është OE "Company Zuka Commerce"Shpk dhe nuk ka ndryshim të Liderit të grupit ndërsa personi z.Albert Bala është i autorizuar nga anëtaret e konzorciumit për dorëzimin e dosjes apo edhe për nënshkrimin e kontratës dhe këtu nuk kemi të bëjmë me ndryshim të Liderit të grupit.

Duke ju referuar arsyetimit të AK-së se në bazë të rregullave të prokurimit publik ofertën e dorëzon bartësi

dhe kjo specifikohet në formular për dorëzimin të tenderit,eksperti shqyrtues sqaron se në LPP dhe legjislacionin dytësor apo në dosje të tenderit askund nuk precizohet apo ndalohet që tenderi të dorëzohet nga ndonjë anëtar i konzorciumit.
Gjithashtu edhe arsyetimi i AK-së për eleminim të OE ankues bazuar në vendimin e OSHP-së PSH.781/19 të datës 09.12.2019 sipas të cilit bartës i projektit është OE i cili i pari e dorëzon ofertën në e-prokurim,për ekspertin shqyrtues është nxjerr nga konteksti sepse në atë vendim është cekur se lider ka qenë i caktuar OE i cili ka qenë edhe dorëzues i ofertës,ndërsa për rastin konkret Lider i grupit është caktuar OE "Company Zuka Commerce"Shpk ndërsa me autorizim të anëtarve të kozorciumit është autorizuar z.Albert Bala të dorëzoj tenderin apo edhe nënshkruaj kontratën në rast se ky grup shpërblehet me kontratë.

Bazuar edhe në interpretimin e KRPP-së të datës 09.10.2020 në të cilin thuhet "Asnjë nga dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit dytësor nuk e ndalon që tenderi të dorëzohet nga një anëtar i konzorciumit.
E rëndësishme është që tenderi të ngarkohet si grup i operatorëve ekonomik (konzorcium) në sistemin elektronik të prokurimit publik"

Eksperti shqyrtues konstaton se dokumentet e grupit të OE N.T.Sh"Marash-Shped"Shpk & "Company Zuka Commerce"Shpk lidhur me themelimin e grupit të operatorëve ekonomik dhe autorizimi për z.Albert Bala janë konform LPP-së,legjislacionit sekondar dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar dhe rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të rivlerësoj tenderin konform nenit 59 të LPP-së duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar**,të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – "KOMUNA E GJAKOVËS"
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – N.T.SH"MARASH-SHPED" & " COMPANY ZUKA COMMERCE" SHPK